



Planuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	26.05.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtupja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMISHAK	3057/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.401/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.401/2022 të datës 20.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi [redacted] kundër Vendimit 02 Nr.57/2022 të datës 05.04.2022 të Menaxherit të Personelit të Komunës së Istogut, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-kthim në vendin e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.401/2022 e datës 20.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi 02 Nr.57/2022 i datës 05.04.2022 i Menaxherit të Personelit të Komunës së Istogut.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Istogut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesin ta kthejë në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 03.11.2011 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës ose në një pozitë tjetër ekuivalente nëse pozita që ka mbajtur ankuesi nuk është e lirë.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi më datë 20.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2237/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit 02 Nr.57/2022 të datës 05.04.2022 të Menaxherit të Personelit të Komunës së Istogut, për shkak të mos vlerësimit të fakteve relevante dhe aplikimin e gabuar të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Istogut, ndërsa kjo e fundit më datë 05.05.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 2237/2022 të datës 20.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin 02 Nr.57/2022 të datës 05.04.2022 të Menaxherit të Personelit të Komunës së Istogut; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2448/2022 të datës 27.04.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2591/2022 të datës 05.05.2022; Vendimin 01 Nr.480/2014 i datës 29.10.2014; Kërkesën për kthim në vendin e punës e datës 22.03.2022 e ankuesit për Menaxherin e Personelit të Komunës së Istogut; Vendimin 01 Nr.743/18 i datës 31.10.2018; Shkresë Emërimi për ankuesin për vendin e punës Sekretar i KK; Akt Emërimit të datës 03.11.2011 në emër të ankuesit; Vendimin me Nr. 01-383/021 i datës 12.07.2021; Vendimin 01 Nr.747/018 i datës 01.11.2018; Vendimin me Nr. 01-841/021 i datës 31.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit

**SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale respektivisht sipas Akt Emërimit të datës 03.11.2011 ankuesi është emëruar në pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit Administrativ të Kuvendit Komunal të Istogut*, pozitë e karrierës në shërbimin civil. I njëjti me Vendimin 01 Nr.480/2014 të datës 29.10.2014 të Kryetarit të Komunës së Istogut është emëruar Nënkyetar i Komunës së Istogut të cilën pozitë e ka ushtruar deri më datë 31.10.2018, ndërsa me Vendimin 01 Nr.747/018 të datës 01.11.2018 të Kryetarit të Komunës së Istogut ankuesi emërohet Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Istogut, duke vazhduar me tej si Drejtor i Drejtorisë për Administratë deri më datë 31.12.2021, ku Kryetari i Komunës së Istogut me Vendimin Nr.01-841/021 ankuesit i ka përfunduar mandatin e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Ankuesi më datë 22.03.2022 ka parashtruar kërkesë me Nr.01/016-1109 pranë organit të punësimit gjegjësisht Komunës së Istogut, për kthim si shërbyes civil në vendin e punës të cilin e ka ushtruar apo edhe një pozitë tjetër ekuivalente. Lidhur me këtë kërkesë të ankuesit, Menaxheri i Personelit i Komunës së Istogut më datë 05.04.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër 02 Nr.57/2022 me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se ankuesi me rastin e emërimit në funksione të ndryshme politike asnjëherë nuk kishte paraqitur kërkesë për pezullimin e marrëdhënies së punës

në shërbim civil ashtu siç është përcaktuar me nenin 55 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që menaxherja e personelit ka bërë vlerësim të gabuar të fakteve, të cilat kanë shpirë në aplikimin e gabuar të dispozitave materiale me rastin e refuzimit të kërkesës për kthim në vendin e punës me mbarim të mandatit ligjor për pezullim të dakorduar. Me tej shton se në kohën kur ka marr pozitë politike ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili nuk ka përcaktuar se nëpunësi civil duhet të parashtojë kërkesë për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës, andaj ky ligj me ka garantuar marrëdhënien e punës po ashtu edhe Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Istogut në përgjigjen në ankesë pretendon se ankuesi me rastin e marrjes së pozitës së Nënkyetarit të Komunë së Istogut, Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorit të Drejtorisë për Administratë, nuk ka pasur vendim për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës në shërbimin civil sepse ankuesi nuk ka bërë asnjëherë kërkesë të tillë.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve të ngritura në ankesë ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankuesit si funksionar publik, fillimisht si Nënkyetar i Komunë së Istogut e me pastaj si Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtor për Administratë, përkatësisht me nenin 3 të këtij ligj është specifikuar qartë se kush konsiderohet nëpunës civilë, ndërsa me nenin 4 paragrafi 1 shprehimisht janë përcaktuar kategoritë e nëpunësve publikë të cilat janë përjashtuar nga shërbimi civil respektivisht me dispozitat në fjalë theksohet se: *Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit, zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale.*

Në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit ju referua nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohej se: *1.Nëpunësit civilë mund të mbajnë, përkohësisht, pozita politike. Gjatë mandatit të tyre në këto pozita, statusi i tyre i nëpunësit civil pezullohet për shkak të mospërputhshmërisë ndërmjet emërimit politik dhe statusit të nëpunësit civil , ndërlidhur me këtë neni 89 paragrafi 1 i të njëjtit ligj parasheh se: 1.Për qëllime të këtij ligji, rastet në vijim konsiderohen pezullim i dakorduar nga shërbimi civil: 1.1. pushimi pa pagesë; 1.2. transferimi i përkohshëm në detyra të tjera brenda ose jashtë Kosovës; 1.3. marrjes së detyrës së funksionarit publik; 1.4. kryerja e obligimeve ushtarake. 2. Pas mbarimit të kushtit të pezullimit të dakorduar, nëpunësi civil ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme ose në një pozitë ekuivalente.” dhe si rrjedhojë Kolegji në kuptim të këtyre dispozitave ligjore konstaton së nëpunësit civil i njëjti e drejta e emërimit në ushtrimin e funksioneve publike, mirëpo me qëllim të eliminimit të papajtueshmërisë në mes të*

ushtrimit të detyrës së shërbyesit civil dhe funksionarit publik, marrëdhënia e punës në shërbim civil pezullohej deri në përfundim të mandatit të funksionit publik, gjegjësisht me përfundimin e detyrës së funksionarit publik, nëpunësi i pezulluar gëzon të drejtën e kthimit në vendin e tij të punës apo në një pozitë tjetër ekuivalente në rast se kjo pozitë nuk është e lirë.

Nisur nga konstatimi si me lartë, Kolegji vlerëson së Menaxheri i Personelit i Komunës së Istogut me rastin e nxjerrjes së Vendimit 02 Nr.57/2022 të datës 05.04.2022 me të cilin ka refuzuar kërkesën ankuesit për kthim në shërbim civil pas përfundimit të mandatit të funksionarit publik, nuk ka vërtetuar drejt faktet dhe nuk ka zbatuar drejtë depozitat materiale lidhur me çështjen, sepse në kohën e emërimit të ankuesit në pozitë të funksionarit publik ka qenë në fuqi respektivisht ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës Kosovës, kështu që, kërkesa e ankuesit për kthim në shërbim civil duhej të trajtohej në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Në këtë kontekst Kolegji thekson se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka filluar së zbatuari nga data 09.07.2020, kështu që Menaxheri i Personelit gabimisht ju është referuar dispozitave të nenit 55 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ky ligj nuk është i zbatueshëm në rastin e ankuesit, andaj, mbi këto arsye rezulton se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave po ashtu konstaton se pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës Kosovës dhe Rregullores Nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil ka qenë kategori ligjore, dhe me asnjë dispozitë të këtyre akteve juridike nuk është përcaktuar detyrimi që nëpunësi civil me rastin e marrjes së funksionit publik duhet të parashtojë kërkesë për pezullim të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Kolegji mbi këtë bazë, si dhe duke marrë parasysh faktin së ankuesi ka ushtruar detyrën e funksionarit publik në të njëjtin institucion, atëherë Kolegji vlerëson së në rastin konkret Njësia përgjegjëse e Komunës së Istogu është dashur që ex officio të veprojë në përputhje me nenin 89 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës Kosovës.

Në mbështetje të dispozitave ligjore të lartpërmendura si dhe bazuar në gjetjet e konstatuar, rrjedhë se nëpunësit civil i garantohet mbrojtja kundër çfarëdo largimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës ose ndryshimi i qëndrimit në detyrë, ashtu siç parashihet me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Përmbledhur si me sipër, Kolegji pas vlerësimit të provave të lëndës si dhe bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30)



ditësh nga dita Anë të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.401/2022

**Avdyll BEKTESHI**

*Behteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Istogut;
- Udhëheqësit të Njëjesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Istogut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

